



Projekti i mekanizmit horizontal: Avancimi i të drejtave të njeriut në Policinë e Kosovës *

Raport vlerëues për Inspektoratin Policor të Kosovës

George Tugushi dhe John Wadham
Konsulentë të Këshillit të Evropës

Mars 2018

** Ky emërtim nuk synon të paragjykojë qëndrimet lidhur me statusin dhe është në përputhje me RKSOKB-së 1244 dhe Opinionin e GjND-së për Shpalljen e Pavarësisë së Kosovës.*

Shkurtesat:

KE – Këshilli i Evropës

KPT – Komisioni Evropian për Parandalimin e Torturës apo Trajtimit ose Dënimit Degradues

KEDNJ – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

GJEDNJ – Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut

ICITAP – Programi Ndërkombëtar për Asistencë në Trajnimin për Hetime Penale

AKSP – Akademia e Kosovës për Siguri Publike

PK – Policia e Kosovës

OSBE – Zyra për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

MPB – Ministria e Punëve të Brendshme

IPK – Inspektorati Policor i Kosovës

ZPP – Zyra e Prokurorit Publik

DSP – Departamenti për Standarde Policore

1. Hyrje

Projekti i Këshillit të Evropës “Avancimi i të Drejtave të Njeriut në policinë e Kosovës”, që është pjesë e “Mekanizmit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” (“Horizontal Facility for Western Balkans and Turkey”), synon të rrisë mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga policia dhe fuqizimin e mëtejshëm të sistemit të kontrollit të pavarur policor.

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësojë pavarësinë funksionale dhe operacionale të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), nevojat për trajnim si dhe kapacitetet. Për të bërë këtë vlerësim, dy konsulentë: George Tugushi dhe John Wadham analizuan ligjet dhe aktet nënligjore relevante, si dhe udhëzuesit dhe rregulloret e brendshme; ata shqyrtuan raporte nga organizata ndërkombëtare dhe jo-qeveritare, si dhe nga organe të tjera aktive në terren. Gjithashtu, konsulentët ishin me mision katër-ditor në Kosovë, nga 5 – 8 shkurt 2018 dhe gjatë këtij misioni, ata u takuan me personat në vijim¹:

- Përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës (Departamenti për Siguri Publike, Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave, Departamenti Ligjor)
- Përfaqësues të Policisë së Kosovës, përfshirë edhe nga Divizioni për Trajnime, Drejtoria për Standarde Profesionale dhe Zyra për të Drejtat e Njeriut
- Përfaqësues të Inspektoratit Policor të Kosovës (të paktën njëzetë pjesëtarë nga të gjitha departamentet e IPK-së)
- Përfaqësues të Akademisë së Kosovës për Siguri Publike
- Përfaqësuesin e Avokatit të Popullit dhe Udhëheqësin e MVP
- Zyrën e Prokurorit të Shtetit
- EULEX, Njësia Këshilluese për Çështje të Brendshme
- Përfaqësues të OSBE-së
- Përfaqësues të ICITAP-it

Konsulentët dëshirojnë t’ju shprehin falenderimet të gjithë palëve të interesit të lartpërmendur që dhanë nga koha e tyre dhe ndanë njohuritë e tyre për këtë vlerësim. Gjithashtu, konsulentët vlerësuan në veçanti bashkëpunimin e stafit dhe drejtuesve të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe IPK.

Së fundmi, por jo për nga rëndësia, vizitat për vlerësim dhe hartimi i këtij raporti u lehtësuan së tepërmi nga Z Shemsedin Aliu, Zyrtar i Lartë i Projekteve pranë Këshillit të Evropës dhe nga ekipi i KiE-së në Prishtinë, ndaj konsulentët i falenderojnë përzemërisht për mbështetjen dhe punën e tyre të madhe.

¹ Më shumë informacion gjendet në agjendën e misionit për vlerësim, e paraqitur si Shtojca 2 e këtij raporti.

2. Vështrim i përgjithshëm i praktikës ndërkombëtare

Zhvillimi i standardeve të Këshillit të Evropës për mbikëqyrje policore është kryesisht i rrënjësor në ndalimin absolut të torturës apo trajtimit dhe dënimit degradues që merr fuqi nga Neni 3 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ). Sidoqoftë, pa detyrimin shoqëruar pozitiv të Shtetit për të hetuar trajtime të asaj natyre, nuk ka gjasa që këto parime apo standarde të ishin zhvilluar dhe vënë në zbatim.

Ndërsa Neni 3 i ka dhënë shtysë zhvillimit të mbikëqyrjes policore, ndikimi i të Drejtës për Jetë (Neni 2 i KEDNJ-së) tek mekanizmat hetimorë nuk duhet të nënvlerësohet. Parimi kryesor rezultues për mbikëqyrjen policore ka mundësuar implementimin e modeleve të mbikëqyrjes në të gjitha 47 Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës që në shkallë të ndryshme zbatojnë detyrimet e tyre pozitive.

Gjykata ka zhvilluar pesë parime kyçe për hetimin efektiv të ankesave ndaj policisë që ndërlidhen me Nenin 2 ose 3 të KEDNJ-së:

- Pavarësia; asnjë lidhje institucionale ose hierarkike ndërmjet hetuesve dhe punonjësit që është subjekt i ankesës, që çon në pavarësi reale, praktike²;
- Kompetenca; hetimi duhet të jetë në gjendje të mbledhë dëshmi për të vërtetuar nëse sjellja policore ndaj së cilës është paraqitur ankesë ka qenë e paligjshme dhe për të identifikuar dhe dënuar ata që janë përgjegjës³;
- Shpejtësia; hetimi duhet të zhvillohet aty për aty dhe me shpejtësi në mënyrë që të ruhet besimi në sundimin e ligjit⁴;
- Shqyrtim publik; procedurat dhe vendimmarrja duhet të jenë të hapura dhe transparente në mënyrë që të sigurohet llogaridhënia; dhe
- Përfshirja e viktimës; ushtruesi i ankesës duhet të përfshihet në procesin e ankesës në mënyrë që të mbrohen interesat e tij apo të saj legjitime⁵.

Nga pikëpamja e Komisionit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit apo Dënimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT), mekanizmi i ankesës është një *masë mbrojtëse themelore* kundër torturës dhe trajnimit çnjerëzor ose degradues të personave që janë të privuar nga liria, pavarësisht a po mbahen nga policia apo mbahen në vende të tjera ku autoriteti publik i ka privuar nga liria. Një mekanizëm i ankesave që funksionon mirë mund të shërbejë edhe si burim i vlefshëm i informacionit për menaxhimin e agjencive dhe institucioneve në fjalë për probleme

² Halat kundër Turqisë, (23607/08) – vendimi i datës 8 nëntor 2011 dhe Mocanu dhe të tjerët kundër Rumanisë (10865/09, 45886/07 and 32431/08) – vendimi i datës 17 shtator 2014

³ Aksoy kundër Turqisë (aplikacioni nr. 21987/93) – vendimi i datës 18 dhjetor 1996; Alder kundër Mbretërisë së Bashkuar (42078/02) – vendimi i datës 22 nëntor 2011

⁴ Aydin kundër Turqisë (57/1996/676/866) – vendimi i datës 25 shtator 1997

⁵ Mekanizma të Mbikëqyrjes Policore në Shtetet Anëtare të Këshillit të Evropës, Jonny Byrne William Priestley, 2017

potenciale. Po ashtu mund të zbusë tensionet ndërmjet personave të privuar nga liria duke i siguruar se shqetësimet e tyre merren dhe trajtohen seriozisht dhe aty ku është e duhur, propozohet kompensimi i përshtatshëm.

Ndërkombëtarisht, ka një sërë modelesh për sisteme të kontrollit policor/ankesave. Nga njëra anë e spektrit, ka vetë-rregullim të plotë, ku policia zhvillon dhe rregullon hetimin e ankesave pa ndonjë mbikëqyrje apo informacione nga jashtë. Një tjetër opsion është një organ tërësisht i pavarur nga policia që mund të merret me ankesat ndaj policisë, organ ky që ka përgjegjësi të plota për hetimin e të gjitha ankesave ndaj policisë. Brenda këtyre dy ekstremeve, ekzistojnë një sërë sistemesh me shkallë të ndryshme të hetimeve të jashtme dhe të brendshme dhe nivele të ndryshme të mbikëqyrjes nga civilët, mbikëqyrjes dhe auditimit të funksionit të trajtimit të ankesave. Organet e ankesave mund të merren me hetimin e veçorive të incidentit për të cilin po ushtrohet ankesë, ose të jenë të kufizuara tek hetimi i procedurave të përfshira për trajtimin e ankesës⁶.

Në të gjithë botën ka shembuj të shumtë ku organet e jashtme dhe të brendshme të mbikëqyrjes policore plotësojnë njëri-tjetrin dhe sjellin rezultate konkrete me punën e tyre. Që të dy sistemet kanë përparësitë dhe mangësitë e veta, që do të shtjellohen më poshtë.

Sipas “Doracakut për Llogaridhënie, Mbikëqyrje dhe Integritet të Policisë” të Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogë dhe Krime (UNODC) llogaridhënia efektive e policisë përfshin shumë palë të ndryshme që përfaqësojnë shtresa të ndryshme të demokracive të ditëve tona, përfshirë përfaqësues të qeverive, parlamentit, gjyqësorit, akterë nga shoqëria civile dhe organe të pavarura mbikëqyrëse si institucione vendore për të drejtat e njeriut. Kryesisht, aty përfshihet edhe vetë policia.

Elementet kryesore për një sistem efektiv të llogaridhënies së policisë përfshijnë:

- Legjislacionin (në përputhje me të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut) që specifikon funksionet dhe fuqitë e policisë
- Udhëzime praktike në bazë të legjislacionit që pasqyron frymën dhe dispozitat e ligjit
- Mundësi që publiku të shprehë shqetësimet
- Politika që përcaktojnë prioritetet se si të shfrytëzohet kapaciteti i policisë
- Trajnim i duhur për policinë, si trajnim bazë, ashtu dhe i vazhdueshëm
- Pajisje të përshtatshme për funksionet e përcaktuara të policisë
- Procedurat dhe mjetet e duhura për raportim
- Mbikëqyrje e duhur që i mbështet punonjësit gjatë kryerjes së detyrave të tyre në mënyrë profesionale dhe për raportimin e tyre me korrektësi
- Kulturë pune që promovon transparencën dhe vlerësimin
- Monitorim të veprimeve dhe operacioneve policore nga udhëheqja e policisë dhe organet e jashtme
- Procedura për ankesa, edhe për paraqitjen e ankesave direkt tek policia dhe tek organe të pavarura

⁶ Mbikëqyrja policore e policisë në Mbretërinë e Bashkuar

- Procedura të drejta dhe efektive për trajtimin e sjelljes së pahijshme, përfshirë kodet disiplinore dhe penale, kapacitetin e duhur hetimor, procedura për dënim dhe procedura për ankesë
- Organ i pavarur që i mbikëqyr këto procedura
- Shqyrtim dhe mbikëqyrje që përfshin edhe informim të policisë në mënyrë që ata të përmirësojnë aktivitetet e ardhshme dhe të parandalojnë keqbërjet e ardhshme
- Procedura për vlerësim dhe ankesa që i kontribuojnë zhvillimit të politikave, procedurave dhe udhëzimeve të reja
- Statistika të besueshme për performancën e policisë, që kanë të bëjnë edhe me efektivitetin për trajtimin e krimit dhe rendit publik, por edhe me integritetin e tyre dhe besimin e publikut
- Procedura për mbikëqyrjen e komenteve, vlerësimit dhe procedurave për ankesave dhe statistikave

Në të gjitha vendet, policia i jep llogari linjës komanduese brenda forcave policore, por edhe autoriteteve të jashtme, zakonisht më së paku Ministrinë të Brendshme dhe/ose kryeministrin (që mund të komandojë policinë), gjyqësorit (aktgjykimet dhe urdhërat e tjerë të të cilit policia duhet t'i zbatojë) dhe legjislaturës (që harton ligje dhe miraton buxhetin e policisë); dhe shpeshherë ekziston dhe ndonjë institucion vendor për të drejtat e njeriut që luan rol në mbikëqyrjen e policisë.

Mekanizmat e brendshëm dhe të jashtëm të llogaridhënies së policisë kanë pikat e tyre të forta dhe të dobëta. Edhe pse sistemet e jashtme me gjasë janë më të besueshme në sytë e publikut, ata kanë më pak gjasa të kenë sukses në zbardhjen e sjelljes së pahijshme sistematike të policisë pa mbështetjen e menaxhmentit të policisë. Shpeshherë atyre u mungojnë shkathtësitë e duhura hetimore, sidomos kur duhet të veprojnë brenda kontekstit të kulturës së mbyllur policore.

Mekanizmat e brendshëm mund të jenë aq efektivë sa edhe përkushtimi i drejtuesve të policisë për të trajtuar rastet e sjelljes së pahijshme dhe shpeshherë, këta drejtues ngurrojnë të ekspozojnë sjellje të pahijshme në shkallë të gjerë, për shkak të efektit të përgjithshëm që do të kishte tek imazhi i të gjithë forcës policore. Si rezultat i besimit të përhapur se drejtuesit e policisë i mbrojnë njerëzit e tyre, mekanizmi i brendshëm është më pak i besueshëm nga këndvështrimi i qytetarëve. Besimi i publikut mund të kompromentohet edhe nga fakti se shpeshherë është e vështirë të kenë qasje në informacion që përftohet përmes shfrytëzimit të mekanizmave të brendshëm ngaqë procesi mund të jetë i padepërtueshëm. Po ashtu, mekanizmat e brendshëm shpeshherë kanë fushëveprim të kufizuar dhe priren të fokusohen vetëm tek masat reaktive (ndëshkuese) kundrejt masave proaktive (parandaluese). Megjithatë, policia ka përgjegjësinë kryesore për integritetin dhe performancën e përgjithshme të forcës policore dhe për rrjedhojë, duhet të vazhdojë të kryejë hetime të brendshme. Kjo mund të ndihmojë dhe të parandalojë që organet e jashtme të stërngarkohen me punë, gjë që mund të vërë seriozisht në rrezik efektivitetin e tyre.

Përparësitë e secilit sistem mund të përmbledhen si më poshtë:

Përparësitë e mekanizmave të brendshëm për llogaridhënie:

- Policia merr përgjegjësi për integritetin e organizatës së vet
- Mekanizmat e brendshëm ofrojnë të kuptuar më të mirë të sjelljes së pahijshme policore dhe të mënyrave se si kjo sjellje e pahijshme mbulohet (përfshirë të kulturës policore)
- Shpesh janë në dispozicion shkathtësi më të mira hetuese

Përparësitë e mekanizmave të jashtëm të llogaridhënies:

- Mekanizmat e jashtëm kanë më shumë besueshmëri në sytë e publikut
- Mekanizmat e jashtëm nuk ndikohen nga fryma e besnikërisë që policë kanë ndaj njërit-tjetrit
- Mekanizmat e jashtëm janë të paanshëm
- Publiku ka shumë qasje në procedurat dhe gjetjet
- Mekanizmat e jashtëm mund ta fuqizojnë policinë që të ruajë integritetin

Llogaridhënia efektive e policisë është kërkesë e së drejtës ndërkombëtare. Mirëpo me po aq rëndësi është që llogaridhënia të jetë përgjegjësi profesionale që shërben si masë e zotimit të drejtuesve të policisë për të vënë në zbatim profesionalizmin dhe integritetin në të gjitha radhët policore. Kjo gjë fillon nga kreu, me drejtuesit dhe menaxherët që vlerësojnë integritetin, ashtu si dëshmohet nga sjellja dhe vendimet e tyre ditë pas dite. Përgjegjësia e drejtuesve të policisë për të siguruar integritetin e policisë dhe respektimin e ligjeve përfshin aspektet në vijim:

- Linjë të qartë komanduese
- Udhëzime dhe urdhëra të qartë dhe të prerë
- Transparencë në vendimmarrje
- Instalimi i një sistemi efektiv të raportimit që përcillet nga mbikëqyrësit
- Procedura standarde operative që i udhëzojnë punonjësit e policisë se si t'i implementojnë ligjet dhe politikat dhe si të kryejnë disa veprime të caktuara
- Krijimi dhe fuqizimi i një mekanizmi për pjesëtarët e publikut që të paraqesin ankesa ndaj policisë
- Mbështetje e pakusht për organizimin e pavarur mbikëqyrës dhe autoritetin e tij lidhur me trajtimin e ankesave
- Krijimi dhe fuqizimi i një mekanizmi ku punonjësit e policisë të mund të paraqesin ankesa, për shembull ndaj një kolegu apo eprori
- Krijimi dhe fuqizimi i procedurës për paralajmërim të keqpërdorimeve
- Strukturë për vënien në zbatim të procedurave disiplinore
- Marrja e masave përmirësuese pas vërtetimit të mospërfilljes së detyrës apo veprave penale

3. Roli dhe funksionet e Ministrisë së Brendshme

Ekzekutivi është ajo degë e Shtetit që është përgjegjës për zbatimin e përgjegjësi të Shtetit. Policia është pjesë e kësaj shtylle ekzekutive. Në shumicën e vendeve, Ministria e Brendshme mbikëqyr policinë, inspekton policinë dhe harton udhëzues për operacionet policore. Llogaridhënia e brendshme përfshin instalimin e një linje efektive komanduese që udhëhiqet nga shefi i policisë së vendit (ose në vendet ku

shërbimi policor është decentralizuar, nga Bordi i Komisionerëve të Policisë). Shefi i policisë së vendit i raporton ose Ministrit të Brendshëm, ose Kryeministrit, i cili nga ana e tij i raporton parlamentit⁷.

Zakonisht, Inspektorati Policor inspekton sa i respekton policia politikat e formuluara nga Ministria në nivel më strategjik dhe nuk merret me rastet individuale të sjelljes së pahijshme të policëve. Këta inspektorate ekzistojnë edhe në vendet ku sundon ligji zakonor, edhe në ato ku sundon e drejta civile, si më poshtë:

- Inspektorati i Policisë së Madhërisë së Saj në Angli dhe Uells, në Irlandën e Veriut dhe Skoci
- Inspektorate të ndryshme për agjenci të ndryshme policore në Francë, si: Inspektorati i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Kombëtare, për Xhandarmërinë; Inspektorati i Përgjithshëm i Policisë Kombëtare që ka qendrën në Paris dhe Inspektorati i Përgjithshëm i Shërbimeve të Policisë Kombëtare për të gjithë pjesën tjetër të vendit⁸.

Disa inspektorate janë struktura të brendshme që nuk janë të ndara nga policia, mirëpo janë pjesë e policisë dhe i raportojnë shefit të policisë, për shembull në Rumani.

Gjithashtu, disa inspektorate, për shembull në Portugali (IGAI), hetojnë ankesat (parashtresat) ndaj policisë. IGAI është shërbim i pavarur për kontroll të jashtëm të aktiviteteve policore. Ai është nën Ministrinë e Punëve të Brendshme (MAI) dhe veprimet e tij mbulojnë të gjitha shërbimet dhe forcat e sigurisë që varen nga ai, për të siguruar respektimin e të drejtave të qytetarëve me fokus tek mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe ruajtja e rendit publik. Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti, IGAI bën rregullisht inspektime, mirëpo edhe zbaton vendime pa paralajmërim nëpër stacione policore për të siguruar respektimin e kërkesave të ligjit dhe të procedurave dhe sidomos, kushtet nëpër qendrat e paraburgimit dhe trajtimin e të paraburgosurve. Në raste më të rënda si keqtrajtimi nga policia, tortura, lëndimi apo vdekja e qytetarëve - IGAI procedon direkt me hetime dhe procese disiplinore dhe i propozon Ministrit që të zbatojë sanksione individuale.

Konsiderohet praktikë e mirë që policia t'i japë llogari një strukture të veçantë qeveritare. Pas llogaridhënies para ligjit, për shumë forca policore kjo është linja e parë e llogaridhënies jashtë vetë forcës⁹.

4. Prezantim i Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK)

Inspektorati Policor i Kosovës u krijua në vitin 2006 nga OSBE-ja me asistencën e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara që iu referuan modeleve të organeve të mbikëqyrjes policore nga e gjithë bota për të krijuar në Kosovë një model të mbikëqyrjes së pavarur të policisë. IPK u themelua si një agjenci

⁷ Doracaku për Llogaridhënie, Mbikëqyrje dhe Integritet të Policisë i UNODC-ut, Seria e Doracakëve të së Drejtës Penale 2011, faqe 96.

⁸ Ibid, faqe 96.

⁹ Ibid.

e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe u krijua për të qenë e pavarur nga vetë Policia e Kosovës. Ligji për Inspektoratin Policor të Kosovës u miratua nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2008 (dhe u ndryshua në vitin 2010).¹⁰

Në fillim, IPK kishte dy funksione si mekanizëm i jashtëm për mbikëqyrje të policisë – (1) të inspektonte strukturat e policisë dhe performancën e tyre, dhe (2) të bënte hetime për të gjitha supozimet për sjellje të pahijshme nga punonjësit e policisë. Lidhur me funksionin e dytë, puna e tij ishte të pranonte nga pjesëtarë të publikut dhe të hetonte ankesat për punonjës të policisë dhe të vendoste nëse ato ankesa i duheshin referuar apo jo Policisë së Kosovës për hetim, apo nëse duheshin hetuar nga vetë IPK. IPK e ka për detyrim të sigurojë që Policia e Kosovës i kryen detyrat dhe përgjegjësitë e veta konform Kodit Evropian të Etikës së Policisë.

Në vitin 2010 u vendos që ligji të ndryshohej për t'i mundësuar IPK të hetonte punonjësit e policisë mbi bazën e supozimeve për shkelje të ligjit penal dhe për t'i dhënë stafit të vet operativ fuqinë e punonjësve të policisë. Si rezultat i këtij ndryshimi, ndryshoi edhe funksioni i procesit të trajtimit të ankesave nga qytetarët. Të gjitha ankesat e qytetarëve, kudo që dorëzohen, i dërgohen së pari IPK për vlerësim. Ankesat mund të bëhen përmes uebfaqes së IPK, përmes një linje të caktuar telefonike për ankesa (Linja e Kaltër), duke vizituar një nga zyrat e IPK ose duke përdorur një nga formularët për ankesa që gjenden në kutitë e posaçme në secilin stacion policor. Në përgjithësi, nëse ankesa nuk supozon vepër penale nga policia, ajo më pas i dërgohet Departamentit për Standarde Profesionale të Policisë së Kosovës që heton sjelljen e pahijshme të supozuar.¹¹ Tani, IPK heton kryesisht aktivitete të supozuara penale dhe këtë e bën nën mbikëqyrjen e prokurorëve. Megjithatë, IPK mbetet përgjegjëse për “indicente disiplinore të profilit të lartë” dhe shkelje disiplinore të “zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutiv”.¹²

IPK mund t'i rekomandojë PK se cilio punonjës policie që po hetohet duhet të pezullohet me pagesë nëse kjo është e nevojshme për qëllime të hetimit. Është praktikë e zakonshme që të gjitha këto rekomandime të implementohen nga PK. Është e pazakontë që prokurori të përfshihet në procesin e pezullimit.

5. Departamenti i Standardeve Policore

Departamenti i Standardeve Policore është Departament në kuadër të Policisë së Kosovës që udhëhiqet nga një Kolonel i policisë, stafi i të cilit heton pohime jo-penale nga qytetarët për sjellje të pahijshme të policisë dhe i bën rekomandime Komisionit Disiplinor. Së dyti, DSP ka përgjegjësi për verifikimin e të kaluarës dhe kontrole të sigurisë. DSP ka zyra rajonale dhe 60% deri 70% të rasteve të veta i merr nga IPK. Shumica e “shkeljeve të lehta” të disiplinës i dërgohen zyrës rajonale të DSP për hetim. DSP mund të inicojë hetime disiplinore jashtë detyrës zyrtare, mirëpo rastet penale ia përcjell IPK.

¹⁰ Ligji Nr 03/L-231 dhe 03/L-036

¹¹ Edhe “lëndimet e lehta” të shkaktuara nga zyrtarët e policisë hetohen nga IPK.

¹² Neni 1.3, 1.4 dhe 1.4 i Ligjit 03/L-231

Shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut – si dështimi i policisë për të mbrojtur ndonjë person në pozitë të cënueshme nga sulmi apo dështimi për ta hetuar një rast të tillë – një pohim i besueshëm i shkeljes së Nenit 3 (ndalimi i torturës apo keqtrajtimit) – nëse nuk identifikohet si krim, atëherë do të hetohet nga vetë DSP.

Komisioni Disiplinor përbëhet nga dyzetë pjesëtarë të policisë që janë të organizuar në panele për shqyrtimin e rekomandimeve nga DSP-ja. Panelet me pesë vetë janë për vendime që kanë të bëjnë me uljen e gradës apo largimin nga puna, ndërsa panelet me tre vetë për raste të tjera. Panelet i marrin rastet nga DSP, mbajnë seancat dëgjimore dhe dëgjojnë dëshmitë, mirëpo rrallëherë nuk mbështesin rekomandimin e DSP. Panelet i mbajnë takimet privatisht, mirëpo mund të mbahen edhe publikisht dhe secila palë mund të bëjë ankesë.

DSP ka sugjeruar që veprat më pak kontraverse – për shembull shkeljet në komunikacion – mund të tranferohen fare mirë për t’u hetuar nga DSP, aq më tepër që IPK duhet të përdorë ekspertë të policisë për hetime të tilla.

Ligji në Kosovë kërkon që qytetarët të cilët ankohen për punonjës të policisë (edhe kur e bëjnë këtë në stacion policor) duhet që së pari rastet e tyre t’i përcjellin në IPK për shqyrtim. Rastet që nuk përfshijnë pohime (supozime) për sjellje kriminale dhe që nuk janë të veçanta¹³ (shumica e rasteve) IPK ia referon sërish për hetim Departamentit për Standarde Profesionale. Kjo dukshëm krijon vonesa. Nga pikëpamja e qytetarëve, krijon edhe pritshmëri se ankesa e tyre do të hetohet në mënyrë të pavarur nga policia, mirëpo më pas kjo nuk ndodh. Edhe pse kjo është pasojë e procedurës së shqyrtimit të pavarur që kryhet nga IPK dhe duhet të mirëpritet, është me rëndësi që çdo vonesë të eliminohet dhe që kjo të jetë e qartë për qytetarin që nga fillimi fare se si funksionon procesi.

6. IPK në hollësi

(a) Misioni i IPK:

“Misioni i Inspektoratit Policor të Kosovës është që përmes aktiviteteve të veta të sigurojë shërbim policor të përgjegjshëm, demokratik dhe transparent në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe standardet e kërkuara.”¹⁴

“Fushëveprimi i aktiviteteve të IPK është:

1. Parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës, pa dallim grade dhe pozite gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj;
2. Inspektimi i strukturave dhe funksioneve të Policisë së Kosovës për të siguruar llogrithënie, efektivitet dhe efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore dhe procedurave standarde të operimit në fuqi;

¹³ IPK është përgjegjëse për incidente disiplinore të profilit të lartë dhe shkelje disiplinore zyrtarëve policorë me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutiv.

¹⁴ Raporti Vjetor 2016, <https://ipk.rks-gov.net/ep-content/uploads/2015/02/Raporti-vjetor-ANG-2016.pdf>

3. Hetimi dhe/ose inspektimi i incidenteve disiplinore të profilit të lartë që përfshijnë punonjës të Policisë së Kosovës;
4. Hetimi i të gjitha shkeljeve disiplinore të supozuara të zyrtarëve policor me gradën më të lartë të nivelit të lartë të menaxhimit dhe zyrtarëve policorë të nivelit të lartë ekzekutiv;
5. Kur ekziston dyshimi i bazuar se drejtori i përgjithshëm apo policia ka bërë shkelje disiplinore, kryeministri mund të autorizojë IPK që të zhvillojë hetimin disiplinor. Pas përfundimit të hetimit disiplinor, IPK i raporton për gjetjet Kryeministrit;¹⁵ dhe
6. Pranimi i të gjitha ankesave të qytetarëve, si dhe shqyrtimi dhe përcaktimi se cilat nga ankesat hetohen nga IPK ose Policia e Kosovës”.

(b) Struktura e IPK:

Aktualisht, IPK përbëhet nga 5 Departamente që janë nën kontrollin direkt të Kryeshefit Ekzekutiv të IPK. Përkatësisht, IPK ka departamentin e hetimeve, departamentin e menaxhimit të ankesave, departamentin e inspektimit, departamentet e planifikimit, bashkëpunimit, çështjeve ligjore dhe informimit si dhe departamentin e financave dhe shërbimeve të përgjithshme. Secili departament ka disa divizione. IPK ka edhe shërbimin e prokurimit dhe auditimit si dhe zyrtarët për certifikim. Këto njësi janë pjesë edhe e zyrës së Kryeshefit Ekzekutiv.

(c) Personeli dhe burimet

Në vitin 2015 IPK kishte 45 hetues, 12 inspektorë dhe 16 staf mbështetës, pra në total 73 punonjës.¹⁶ Në fillim, në vitin 2006, asnjë nga këta punonjës nuk ishin ish-punonjës të policisë, por punonjësit e policisë rekrutoheshin ose transferoheshin për të trajtuar ato nevoja që kërkonin ekspertizën e tyre specifike kur mandati i IPK ndryshoi dhe ekipet hetuese duhej të merreshin edhe me raste penale. U vlerësua se vetëm disa nga rreth njëzetë vetë në stafin e rekrutuar gjatë gjithë kohës që IPK ka ekzistuar ishin ish-punonjës të policisë. Kohëve të fundit, rritja e buxhetit ka mundësuar edhe rekrutimin e katër drejtorëve të departamenteve dhe 23 punonjësve të tjerë. Megjithatë:

“Ndërkohë që procesi i përzgjedhjes së drejtorëve të departamenteve përfundoi në mars 2017, rekrutimi i 23 pjesëtarëve të personelit është shtyrë për shkak të vonesave në alokimin e buxhetit. Duke patur parasysh se e gjithë rritja e buxhetit të vitit 2017 është shpenzuar për rekrutimet e reja dhe trajnime, faza e dytë e rajonalizimit në formën e krijimit të tri zyrave të reja rajonale gjithashtu është shtyrë. Ndërkohë, zyrat rajonale të IPK që u hapën në Mitrovicën e Veriut, në Gjilan dhe në Prizren në vitin 2015 funksionojnë me nga një zyrtar secila, gjë që kufizon punën e tyre kryesisht në pranimin e

¹⁵ Neni 2 (1.5) i Ligjit për Inspektoratin Policor të Kosovës.

¹⁶ Raporti Vjetor 2015 <https://ipk.rks-gov.net/wp-content/uploads/2015/02/Annual-Report-2015.pdf>

ankesave. Po ashtu, këto zyra nuk janë të pajisura sa duhet dhe nuk kanë automjete zyrtare”.¹⁷

(d) Ankesat

Gjatë vitit 2016 IPK ka pranuar 1,362 ankesa (në krahasim me 1,237 në vitin 2015) që kanë të bëjnë me 8,902 pjesëtarë të Policisë së Kosovës. Një numër prej 241 punonjësish të policisë ishin subjekt i hetimeve nga IPK. Pas shqyrtimit, rreth tetëqind raste nga këto i janë dërguar vetë policisë së Kosovës për hetim, ndërsa shumica e pjesës së mbetur u hetuan nga IPK. Më tej, hetimet paraprake nga IPK rezultuan që pothuajse gjysma e këtyre pesëqind rasteve t'i ktheheshin policisë për hetime disiplinore. Rreth njëqind e pesëdhjetë raste iu dërguan prokurorisë.¹⁸

(e) Inspektimet

IPK vlerëson mënyrën se si Policia e Kosovës kryen detyrat e veta, duke:

- “Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret relevante dhe parimet e procedurat e Policisë së Kosovës implementohen ashtu si duhet nëse janë hartuar në mënyrë të tillë që të arrihen qëllimet e veta;
- Përcaktuar nëse burimet e Policisë përdoren në mënyrë efektive dhe efikase në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e organizatës;
- Parandaluar shkeljet që mund të ndodhin gjatë aktivitetit të Policisë së Kosovës;
- Identifikuar mangësitë përmes rekomandimit të masave ligjore dhe organizative për funksionimin më të mirë të Policisë së Kosovës”.¹⁹

Raporti Vjetor bën përmbledhjen e programit të inspektimit për vitin 2016 si më poshtë:

Inspektimet e rregullta

1. Vlerësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore për shpërndarjen e stafit në Policinë e Kosovës;
2. Vlerësimi i organizimit dhe performancës së stacioneve policore në Divizionin e Operacioneve;
3. Inspektimi i dhomave të paraburgimit në Policinë e Kosovës;
4. Inspektimi i menaxhimit të armëve, municionit dhe pajisjeve të tjera;
5. Inspektimi i procedurave për shoqërim, paraburgim dhe arrestim nga Policia e Kosovës;

Inspektimet e jashtëzakonshme

1. Vlerësimi i performancës së punonjësve të policisë më 28 nëntor 2015;

¹⁷ Raporti Kompakt i Progresit i Eulex-it <http://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/CPR-2017.pdf>

¹⁸ Raporti Vjetor për vitin 2016

¹⁹ Raporti Vjetor për vitin 2016

2. Vlerësimi i efikasitetit të patrullave të përbashkëta policore të Kosovës dhe Shqipërisë përgjatë kufirit Kosovë-Shqipëri;
3. Vlerësimi i efikasitetit në implementimin e memorandumit të bashkëpunimit për organizimin e përbashkët të kontrollit policor rrugor ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Policisë Shtetërore të Shqipërisë gjatë stinës së verës në Republikën e Shqipërisë;
4. Vlerësimi i performancës së policisë gjatë ndërrimit që zgjaste 08-16 orë në stacionet e policisë të kategorisë "A" të datës 14.10.2016“.

Raportet e inspektimeve i janë dërguar Ministrit të Punëve të Brendshme dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe më pas janë publikuar edhe në uebfaqen e IPK.²⁰

7. Gjendja aktuale në terren dhe vlerësimi nga konsulentët

Ky vlerësim është mbështetur në tri konsiderata:

- Është i mbështetur në prova, sepse konsulentët u takuan me një numër të konsiderueshëm të njerëzve që kanë punuar në kuadër të ose përkrah IPK, përfshirë dhe një numër të konsiderueshëm të stafit të IPK dhe OJQ-ve relevante aktive në fushën e luftimit të keqtrajtimit policor dhe që përfaqësonin qytetarët të cilët kishin ushtruar ankesa ndaj policisë;²¹
- Analizë e hollësishme e ligjeve relevante, raporteve vjetore të IPK dhe dokumenta të tjerë; dhe
- Standardet aktuale evropiane, përfshirë ligjet, konventat, rekomandimet, dokumenta ligjorë dhe praktikat më të mira.

Për qëllime të këtij raporti, duhet të bëjmë dallimin ndërmjet funksionimit të mekanizmave mbikëqyrës të policisë të brendshme dhe të jashtme. IPK është dizajnuar si mekanizëm i jashtëm i mbikëqyrjes me një shkallë domethënëse të pavarësisë nga forca policore, por që i jep llogari MPB, prandaj kemi vënë në zbatim standardet që duhet të jenë të zbatueshme për organe të cilat konsiderohen si mekanizma të pavarura të jashtme për ankesa ndaj policisë, të cilave shpesh u referohemi si mekanizma/organe të pavarura hetimore që kryesisht kanë mandat të hetojnë krimet e kryera nga policia.

Ombudspersoni i Policisë në Irlandën e Veriut është shembull i mirë i sistemit tërësisht të pavarur të ankesave ndaj policisë dhe është interesant, sepse u krijua në një vend pas-konfliktit.

“Kur Zyra e Ombudspersonit të Policisë nisi punën më 6 nëntor 2000, kjo zyrë nisi një periudhë të re për ankesat ndaj policisë në Irlandën e Veriut. Para saj, ankesat ndaj policisë hetoheshin nga policë të tjerë. Hapja e Zyrës shënjo

²⁰ <https://ipk.rks-gov.net/?lang=en>

²¹ Sipas praktikës së zakonshme të misionëve vlerësues të Këshillit të Evropës, konsulentët nuk patën mundësi të hulumtojnë në mënyrë të pavarur thëniet, komentet apo supozimet e bëra rreth rasteve specifike aktuale apo në të kaluarën që janë trajtuar nga organi mbikëqyrës.

sjelljen e një sistemi të pavarur, të paanshëm, të mbikëqyrjes civile ndaj punës së policisë. Me ekipet e veta të hetuesve profesionistë, ishte organizata e parë në botë e financiar tërësisht dhe krejtësisht e pavarur që merrej me ankesat ndaj policisë”.²²

Zyra e Pavarur për Sjelljen e Policisë në Angli dhe Uells është gjithashtu e pavarur, mirëpo ashtu si IPK, nuk heton çdo ankesë ndaj policisë, mirëpo merret vetëm me incidentet dhe ankesat që kanë të bëjnë me policinë dhe që janë më të rënda.²³

Disa vende kanë zgjedhur lloje të tjera të mekanizmave të pavarur të brendshëm të kontrollit përmes fuqizimit të pavarësisë institucionale të shërbimit dhe sigurimit të mandatit për menaxherë të organeve relevante. Përvoja suedeze është një shembull interesant. Që nga 1 janari 2015 është krijuar Departamenti i Brendshëm për Hetime i Policisë. Kreu i Departamentit emërohet nga Parlamenti për një mandat të caktuar dhe i raporton direkt Qeverisë dhe jo Komisionerit të Policisë. Pavarësisht ndryshimeve domethënëse, KPT sërish kishte ngritur disa shqetësime në raportin e vet të vizitës së vitit 2015, raport ky i destinuar për Qeverinë Suedeze. Në mënyrë më specifike, KPT vlerësonte pozitivisht krijimin e Departamentit të ri të Brendshëm për hetime, pasi konsideronte se krijimi i një organi të ri adresonte pjesën më të madhe të shqetësimeve të KPT sa i përket hetimit të ankesave ndaj policisë. Në veçanti, pavarësia e mekanizmit ishte fuqizuar dukshëm. Megjithatë, Departamenti i Brendshëm për Hetime ende mund të varet nga punonjësit e policisë që gjatë aktiviteteve të veta hetimore punojnë në njësi policore “të zakonshme”, nëse kjo paraqitet si nevojë nga shkaku i kompleksiteti i çështjes. Për më tepër, mbetet çështje e hapur nëse publiku i përgjithshëm do ta perceptojë gjithashtu Departamentin e ri si të pavarur, duke patur parasysh se ai është ende formalisht pjesë e Autoritetit Policor të Suedisë (ashtu si edhe sugjerohet nga vetë emërtimi i Departamentit). Prandaj, Komisioni e përsëriti rekomandimin e vet se autoritetet suedeze duhet të rishqyrtojnë nevojën që hetimi i ankesave ndaj policisë t’i besohet një agjencie, e cila është haptazi e pavarur nga policia²⁴.

Një tjetër opsion për fuqizimin e pavarësisë së mekanizmave të brendshëm të kontrollit që përdoret nga disa vende të tjera është emërimi i kreut të mekanizmit nga Ministri, por për një mandat të caktuar dhe me masa mbrojtëse të fuqishme të përfshira në ligjin relevant në mënyrë që të sigurohet mandati i emërimit.

(a) IPK

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Dënimit Çnjerëzor ose Degradues (KPT) në raportin e tij mbi vizitën e vitit 2015 në Kosovë ka shënuar se Ligji i ri për Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK)⁷ ishte miratuar në tetor 2010. Sipas këtij ligji,⁸ pavarësia e IPK është fuqizuar dhe kompetencat e tij janë shtrirë edhe në kontekst të hetimeve penale kundër zyrtarëve të PK. IPK është institucion ekzekutiv nën Ministrinë e Punëve të Brendshme, detyrë e të cilit është të zhvillojë hetime

²² <https://policeombudsman.org/About-Us/History-of-the-Office>

²³ <https://www.policeconduct.gov.uk> Kjo organizatë është ristrukturuar dhe riemëruar kohëve të fundit. Fillimisht, kur u krijua në vitin 2003, u quajt Komisioni i Pavarur për Ankesa Ndaj Policisë.

²⁴ Raporti i KPT-së për vizitën e vitit 2015 për Qeverinë Suedeze, paragrafi 24.

disiplinore penale dhe të profilin të lartë⁹ në raste potenciale të sjelljes së pahijshme (përfshirë torturën dhe keqtrajtimin) nga zyrtarët e PK, si dhe për të zhvilluar inspekte të qendrave dhe shërbimeve të PK. Hetimet penale zhvillohen nën prokurorin publik kompetent. IPK është i pavarur nga Policia e Kosovës dhe funksionon nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të Ministrit të Punëve të Brendshme, autoriteti i të cilit nuk përfshin menaxhimin operativ të IPK. Ia vlen gjithashtu të përmendet se IPK mund të mos i japë as Ministrit, as ndonjë autoriteti apo personi tjetër, informacion që ka të bëjë me hetimet e veta. IPK udhëhiqet nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe ka në përbërje një total prej 48 hetuesish dhe 13 inspektorësh²⁵.

Në të vërtetë, Avokati i Popullit, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe të tjerë e konsiderojnë IPK si strukturë të rëndësishme për llogaridhënien e policisë në Kosovë. Stafi i këtij institucioni ishin entuziastë për detyrat e tyre, ishin të përkushtuar ndaj mandatit të IPK dhe të përkushtuar në përpjekjet e tyre për të përmirësuar efektivitetin e tij. Shumica ishin të pajtimit se shkathtësitë dhe ekspertiza e hetuesve kishin nevojë për disa përmirësime. Stafi i IPK, disa OJQ dhe të tjerë sugjeruan gjatë misionit se IPK nuk ishte dhe aq efektiv kur ishte fjala për hetimin e zyrtarëve të lartë të policisë. Është e vështirë të kuptohet pse mund të jetë kështu, sepse ligji dhe procedurat e nevojshme për këto hetime tashmë ekzistojnë. Disa nga ata që dhanë deklarata për konsulentët sugjeruan se kjo mund të ndodhë për shkak të ndikimit të fuqishëm të atyre zyrtarëve të policisë, përfshirë dhe ndikimin e tyre brenda MPB-së.

(b) Inspektimi

Stafi i IPK u ankua se gjatë inspektimeve, punonjësit e PK-së ndonjëherë ngurrojnë t'i dorëzojnë IPK-së dosje për shqyrtim, sidomos kur IPK kërkon dosje të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Ky ngurrim duket të jetë pjesërisht për shkak se dorëzimi i dosjeve nuk ishte autorizuar nga prokurori mbikëqyrës (edhe pse IPK nuk ka nevojë për pajtimin e prokurorit në raste të tilla). Refuzime të tilla mund të zgjidhen vetëm nëse inspektori kontakton me zyrtarë të lartë të IPK-së të cilët nga ana e tyre duhet të kontaktojnë me zyrtarë të lartë të policisë. Konsulentëve iu tha se në disa raste, zyrtarë të lartë të IPK-së kanë ngurrar të veprojnë ashtu. Policia ka fuqinë të refuzojë ose të dorëzojë dosje tek IPK duke u thirrur në baza të konfidencialitetit. Deri më tani, IPK nuk ka inicuar asnjë veprim penal apo disiplinor kundër zyrtarëve të policisë që kanë refuzuar të përmbushin kërkesa të tilla të ligjshme. Më tej, Ministria e Punëve të Brendshme ka shpjeguar se këto çështje nuk janë sistematike, edhe pse mund të ketë ndodhur ndonjë rast i izoluar, tashmë këto çështje janë zgjidhur.

(c) Trajnimi

Për trajnimin e stafit të IPK janë caktuar burime të konsiderueshme që nga fillimi i ekzistencës së këtij institucioni në vitin 2006 (nga OSBE-ja dhe të tjerë).²⁶ Kur mandati i IPK u ndryshua në vitin 2010, u implementuan module të reja të trajnimit. Tani, IPK po zhvillon planin e vet të trajnimeve dhe një pjesëtar i stafit të IPK është

²⁵ Raporti i KPT-së për vizitën e vitit 2015 në Kosovë*, paragrafi 10.

²⁶ Përmbledhja e trajnimit të ofruar për IPK-në gjatë viteve të para të funksionimit paraqitet në Raportin Vjetor të IPK-së për vitin 2015 dhe për vitin 2016 në Raportin Vjetor të vitit 2016.

caktuar dhe ka përgjegjësi specifike për këtë funksion. Është bërë vlerësimi i nevojave për trajnim brenda institucionit dhe stafi i IPK ka propozuar listën e trajnimeve që duan të ndjekin gjatë vitit 2018. Lista përfshin 26 module trajnimi për tema të ndryshme, përfshirë trajnim të avancuar për rastet hetimore të trafikimit të qenieve njerëzore, hetimin e krimeve të ndërlidhura me drogën, inspektimin e vendit të ngjarjes, analizimin e burimeve të informacionit, aktivitete të shërbimit të inteligjencës, hetimi i krimeve financiare dhe ekonomike si dhe krimin të organizuar dhe raste të korrupsionit/mashtimit, infiltrimi i agjentëve dhe menaxhimi i operacioneve të fshehta, aftësi të avancuara të intervistimit, rregullat e procedurës për arrest dhe paraburgim nga policia dhe koncepte të kontrollit policor në komunitet. Po ashtu, stafi i IPK ka identifikuar dhe nevoja për trajnim si bashkëpunimi dhe ndjekja penale ndërkombëtare, hartimi i raporteve të inspektimit, procedurat e prokurimit, auditimi, kontrolli i financave publike, menaxhimi i burimeve njerëzore, statistikën, teknologjinë e informacionit, vendimarrja dhe planifikimi operacional.

Është e qartë se shumica e trajnimeve në dispozicion ka gjasë të ofrohen në praktikë nga Akademia Kosovare për Siguri Publike dhe do të organizohen bashkërisht me trajnimin e punonjësve të policisë. Është po ashtu e qartë se Akademia nuk ka kapacitet të ofrojë trajnime për të gjitha temat e listuara nga stafi i IPK-së. Duhet që IPK të krijojë një listë të ngushtë të prioritetëve më të rëndësishme të nevojave për trajnim që duhet të planifikohen dhe të implementohen gjatë vitit në vijim dhe më pas këto kërkesa t’ia dërgojë organizatave që janë të gatshme t’i asistojnë IPK me ofrimin e trajnimeve brenda institucionit dhe me asistencë nga donatorët.

Ishte e qartë se janë mbajtur një numër i madh i trajnimeve për të drejtat e njeriut, mirëpo ende duhet të përcaktohet se sa nga këto trajnime kanë qenë të bazuara në praktikë dhe që mund të integrohen lehtësisht në punën e përditshme të IPK.

Është shprehur njëfarë shqetësimi për trajnimet – trajnimet e mbajtura nga zyrtarë me më shumë përvojë për pjesën tjetër të personelit të IPK ka ulur kapacitetin e përgjithshëm për t’u marrë me hetime dhe inspekte.

Personeli i IPK ka shprehur dëshirën për trajnim të avancuar, ndoshta nga ekspertë nga vende të tjera dhe për vizita studimore në organe të tjera të mbikëqyrjes së policisë dhe këto duhet të dizajnohen në mënyrë specifike për punën e IPK (në vend se të kufizohen në trajnime më të përgjithshme bashkë me zyrtarë të tjerë të policisë).

(d) Roli i prokurorëve

Mbikëqyrja e rasteve të IPK nga prokurorët në një fazë të caktuar u trajtua nga prokurorë të caktuar në mënyrë specifike, mirëpo tani, prokurorët e caktuar varen vetëm nga zona ku është kryer krimi. Konsulentët u informuan se konfliktet e interesit të cilat mund të rezultojnë nga prokurorët që punojnë rregullisht me punonjës të policisë trajtohen nga vetë prokurorët që i identifikojnë këto dhe kërkojnë përjashtim (ose identifikohen nga mbikëqyrësit e tyre). Në “Opinionin e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut lidhur me vendosjen e pavarur dhe efektive të ankesave ndaj policisë” Komisioneri i Këshillit të Evropës ka deklaruar:

“Në disa shtete anëtare ekziston shqetësimi se marrëdhënia e ngushtë e punës ndërmjet policisë dhe autoritetit të prokurorisë gjatë procedurave penale standarde mund të çënojë pavarësinë dhe paanshmërinë e praktikës së ndjekjes penale. Një shkak madhor për shqetësim është se bashkëpunimi ndërmjet hetuesve të policisë dhe prokurorëve mund të çënojë pavarësinë e prokurorëve kur merren me raste kundër policëve. Në përpjekje për ta trajtuar këtë problem, autoritetet e specializuara të ndjekjes penale bashkë me hetuesit e tyre janë vendosur në disa juridiksione për të hetuar ankesat ndaj policëve dhe për të zhvilluar procedura penale.”²⁷

Caktimi i rasteve të IPK-së dhe emërimi i prokurorëve mbikëqyrës nuk është përgjegjësi e IPK-së dhe kjo kompetencë është e autoriteteve të prokurorisë. Ministria e Punëve të Brendshme mendon se “vlerësimi se caktimi i prokurorëve të cilët do të merreshin ekskluzivisht me rastet e paraqitura nga IPK-ja do ta bënte më efikas procesin e trajtimit të rasteve kundër policisë.”

Konsulentët morën informacion edhe për vështirësitë e komunikimit ndërmjet stafit të IPK dhe prokurorëve. Ndonjëherë ata kanë vështirësi me marrjen e udhëzimeve nga prokurorët se si duhet të veprojnë në ndonjë hetim. U ngritën shqetësime se prokurori jo gjithnjë raporton për progresin e ndjekjes penale (pavarësisht a i dërgohet gjykatës apo jo dhe/ose rezultatit të procedurave).²⁸ Kjo është mjaft frustruese për të gjithë hetuesit e ndërgjegjshëm dhe krijon shqetësime shtesë lidhur me ato procese paralele disiplinore dhe nuk është praktikë e mirë për punonjësit e policisë që janë nën dyshime kur rasti i tyre trajtohet menjëherë. Thuhet se prokurorët janë në dijeni të këtyre sfidave dhe dëshirojnë t’i tejkalojnë – mundësisht pasi të krijohet ndonjë sistem i përbashkët i menaxhimit të lëndëve, edhe pse për këtë mund të duhet kohë. U sugjerua që ndonjë Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet IPK dhe prokurorëve mund të ndihmojë me përcaktimin e përgjegjësiave relevante.

(e) Fuqi shtesë

Stafi i IPK kishte shqetësime për vështirësitë e ndërlidhura me zhvillimin e hetimeve mbi integritetin e punonjësve nën dyshime për aktivitet penal apo sjellje të pahijshme të rëndë. U identifikuan dy probleme. I pari, për shkak të nevojës që të sigurohet pajtimi i prokurorit mbikëqyrës, gjë që rezultoi të jetë e vështirë. I dyti (dhe ndoshta pjesërisht për shkak të problemit të parë), në Kodin Penal të Kosovës kishte zbrazëti, gjë që nënkupton se këto procedura nuk janë të mundura për IPK. Përpjekjet për ta përmirësuar këtë problem nuk kanë qenë të suksesshme. Del se IPK e vlerëson parimin e agjencive që zbatojnë ligjin për të shmangur shtytjen në raste penale dhe kjo fuqi respekton edhe standardet evropiane.²⁹ Nuk ka ndonjë masë parandaluese ekuivalente në Evropë për ndalimin e shtytjes vetëm në raste disiplinore.

²⁷ <https://rm.coe.int/16806daa54>

²⁸ Mungesa e informacion e pengon IPK që t’i raportojë saktë arritjet në formë statistikore në Raportet e veta Vjetore.

²⁹ Shih për shembull aktgjykimin e GJEDNJ Veselov dhe të tjerët kundër Rusisë, 2012.

IPK gjithashtu ka sugjeruar se duhet të ketë fuqi të nevojshme mbikëqyrëse dhe burimet e duhura për të krijuar një njësi të mbikëqyrjes që të përdorë pajisjet e reja teknologjike për grumbullimin e provave. Po ashtu u sugjerua që këtu duhet të përfshihet edhe aftësia për të zhvilluar rrjetin e informatorëve. Nuk ka dyshim se këto mjete do t'i ndihmonin IPK në punën e vet dhe për të identifikuar aktivitetet kriminale të punonjësve të policisë, për t'i dëshmuar dhe për të siguruar se fajtorët dënohen. Ato mund të zhvillohen dhe të vihen në dispozicion të IPK sapo IPK të jetë në gjendje t'i përdorë si duhet dhe me kujdes, në varësi të kontrolleve relevante dhe vetëm në përputhje me legjislacionin për procedurë penale të Kosovës dhe vetëm duke respektuar ligjet e tjera, si ligjin për mbrojtjen e të dhënave dhe standardet evropiane, në mënyrë që të parandalohet çfarëdo abuzimi i mundshëm.

Çdo mbikëqyrje nga shteti, përfshirë edhe nga IPK, ka gjasë të sjellë në përdorim Nenin 8 të KEDNJ (e drejta në privatësi) që është një e drejtë e kualifikuar. Prandaj, në mënyrë që të arsyetohet ndërhyrja nga shteti në të drejtat e një personi sipas Nenit 8, kjo gjë duhet të bjerë nën njërin prej përjashtimeve të shtjelluar në Nenin 8(2) dhe duhet të përmbushë kërkesat e përgjithshme të arsytimit (duhet të jetë në përputhje me ligjin dhe i nevojshëm në një shoqëri demokratike). Praktika gjyqësore relevante nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut sjell udhëzues të hollësishëm për këtë çështje³⁰.

Si Zyra e Pavarur për Sjelljen e Policëve³¹ ashtu dhe Ombudspersoni i Policisë së Irlandës së Veriut³² kanë fuqinë që t'i përdorin këto mjete hetimore. Ashtu si është thënë më lart, posedimi i mjeteve të tilla nga organet përgjegjëse për mbikëqyrjen e policisë mund t'i kontribuojnë kryesisht rritjes së efektivitetit të hetimeve të tyre kur ekzistojnë masa mbrojtëse ligjore dhe operacionale të përshtatshme. Këto mjete i bëjnë edhe më pak të varur nga përfshirja e policisë në punën e tyre. Rrjeti Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit sugjerojnë edhe parimin kyç më poshtë:

“Hetuesit e organit mbikëqyrës të policisë duhet të pajisen me spektrin e plotë të fuqive policore për t'iu mundësuar hetime të drejta, të pavarura dhe efektive, sidomos me fuqinë për të siguruar të gjitha informatat e nevojshme për të zhvilluar hetim efektiv”.³³

Shërbimi i zbatimit të ligjit në doganën e Kosovës nuk mbikëqyret nga IPK. Kjo është për të ardhur keq dhe duhet të rregullohet, mirëpo prioriteti aktual duhet të jetë ndërtimi i efektivitetit dhe kapacitetit të IPK para se t'i shtohen detyrime të tjera.

(f) Vonesat dhe komunikimi

Procesi i përgjithshëm i hetimit, ndjekjes penale, seancave dëgjimore penale dhe zgjidhja e rasteve disiplinore mund të jenë të tepërta. Çdo hetim disiplinor duhet të

³⁰ Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, 35394/97, 12 maj 2000 36

Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar 2 gusht 1984, § 84, Seritë A nr. 82

Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, 3 prill 2007 Nr. 62617/00.

³¹ Komisioni i Pavarur për Ankesa ndaj Policisë (Fuqitë Hetimore) Urdhëri 2004

³² Rregullimi i Fuqive Hetimore (Mbikëqyrje e Kontrolluar dhe Burime të Fshehura të Inteligjencës Njerëzore) Urdhëri 2013

³³ Parimi 2.5.1. dhe shih paragrafin 3(a) të Parimeve të OKB-së për Hetimin Efektiv dhe Dokumentimin e Torturës dhe Trajnimit ose Dënimit Tjetër Mizor, Çnjerëzor dhe Degradues

zgjidhet brenda një periudhe të kufizuar specifike, mirëpo koha pezullohet për aq sa zgjat procesi penal. Nuk ka ndonjë ndalesë ligjore që pengon disiplinimin apo largimin e punonjësit të policisë para përfundimit të procesit penal paralel, mirëpo nuk është e qartë sa shpesh ka ndodhur kjo.

(g) Vetëdijësimi

IPK i ka zgjedhur burimet e veta për të nxitur vetëdijësimin për sistemin e vet të trajtimit të ankesave (përfshirë dhe Linjën e Kaltër të telefonatave) mirëpo njësoj si në shumë sisteme të ankesave në Evropë, ofrimi i informacionit të dobishëm për ankesa ndaj policisë për të gjithë është detyrë e vështirë. Zhvillimi i zyrave rajonale është një shenjë shumë pozitive dhe duhen vënë në dispozicion burime që këto zyra të krijohen sa më shpejt. OJQ-të kanë shprehur shqetësim se shumë qytetarë, sidomos të rinj, nuk e kuptojnë sistemin. Informacioni duhet t'i drejtohet një publiku më të gjerë në mënyrë që qytetarët t'i kuptojnë të drejtat e tyre për t'u ankuar dhe si funksionon kjo. Ndoshta informacioni mund t'iu drejtohet edhe atyre që kanë ndërveprim më të vështirë me policinë (të rinjtë, grupet protestuese dhe grupet e cënueshme). Ekziston edhe nevoja për t'u siguruar se materiali vihet në dispozicion edhe në gjuhë të tjera (edhe në uebfaqen e IPK), duke filluar me gjuhët zyrtare të Kosovës.

(h) Muri i heshtjes dhe paralajmëruesit

Nuk ishte e qartë se a ka patur apo jo ndonjë sistem apo procedurë specifike që kanë inkurajuar apo mbrojtur punonjësit e policisë që e kanë informuar IPK për vepra penale apo sjellje të pahijshme nga kolegët e tyre, por IPK nuk ka dhënë asnjë shembull që kjo të ketë ndodhur. Në Mbretërinë e Bashkuar, të gjithë punonjësit, përfshirë edhe policët, janë të mbrojtur nga largimi nga puna nëse raportojnë një krim të kryer nga kolegët e tyre. Paraqitja e keqbërjes duhet të jetë në interesin e publikut. Kjo do të thotë se ajo duhet të prekë të tjerët, publikun e përgjithshëm. Një person që bën një paralajmërim të tillë mbrohet me ligj dhe nuk duhet të trajtohet në mënyrë të padrejtë dhe nuk duhet ta humbasë punën vetëm sepse "i ka rënë bilbilit".

(i) Burimet dhe stafi

IPK do të përfitojë edhe nga stafi shtesë dhe gjithashtu ka nevojë për ekspertë të tjerë në një shumëllojshmëri lëmish, si dhe burime për t'i paguar ata (sidomos ekspertët mjeko-ligjorë). Megjithatë, përdorimi i ekspertëve të policisë, nëse mbikëqyret dhe kontrollohet si duhet nga hetuesit e IPK dhe kjo bëhet për pjesë më pak kontraverse apo më pak të ndjeshme të hetimeve, është mundësi që nuk duhet të lihet anash. Do të ishte e arsyeshme që IPK të ketë kapacitete, përfshirë dhe ato financiare, për të punësuar direkt të gjithë ekspertët që nevojiten rregullisht dhe për të minimizuar përdorimin e ekspertëve nga Policia sa më shumë të jetë e mundur.

Së fundmi, u sugjerua që IPK ka nevojë për një dhomë të sigurtë për provat gjatë hetimit dhe para se e gjithë dosja t'i transferohet prokurorisë për shqyrtim.

(j) Pavarësia

Ka prova të qarta se IPK është i pavarur nga policia, si në ligj, ashtu edhe në praktikë. Megjithatë, ka patur disa supozime nga disa OJQ dhe disa bashkëbisedues se IPK nuk është dhe aq efektiv sa duhet me hetimet që bën për punonjësit e policisë .

Ligji e parasheh IPK si agjenci ekzekutive të MPB-së. Neni 6(1):

“IPK është institucion ekzekutiv në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e pavarur nga Policia e Kosovës dhe në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit”.

Edhe pse ky nen konfirmon qartë pavarësinë e IPK nga PK, marrëdhënia me Ministrinë është formuluar më pak qartë.³⁴ Buxheti i tij, edhe pse është linjë më vete, është pjesë e buxhetit të MPB.³⁵ Ministria e Punëve të Brendshme i ka informuar autorët e këtij raporti se Ministri vazhdimisht jep mbështetjen e tij për rritjen e buxhetit të IPK-së. Këtë e bën si publikisht, ashtu edhe në diskutimet e brendshme me qeverinë dhe Ministrinë e Financës. Po ashtu, Ministri ka kërkuar përkrahjen dhe përfshirjen e Kuvendit, të Komisionit për Punë të Brendshme dhe të palëve të tjera relevante që të ndihmojnë me zgjidhjen e problemeve të kohëve të fundit në IPK, si dhe me përmirësimin e funksionimit dhe llogaridhënies së IPK-së.

Kryeshefi Ekzekutiv emërohet nga Komisioni i Lartë Publik në përputhje me procedurën për emërim të zyrtarëve të lartë të shërbimit civil dhe kjo ofron më shumë pavarësi. Komisioni i propozon Ministrit tre kandidatë dhe Ministri emëron njërin nga tre kandidatët e propozuar nga Komisioni. Megjithatë, mbrojtja nga ndërhyrjet e MBP në aktivitetet operacionale, përfshirë rastet e hetuara, parashihet fuqishëm në ligjin për IPK.³⁶

“Çdo person përgjegjës për udhëheqjen dhe kontrollin e organit mbikëqyrës të policisë duhet të emërohet me ligj dhe t’i japë llogari kuvendit legjislativ apo komitetit të përfaqësuesve të zgjedhur që nuk ka përgjegjësi të shprehura për kryerjen e shërbimeve policore”.³⁷

Ekziston gjithnjë mundësia që detyrimet raportuese të organit që mbikëqyr policinë për ministrinë të lejojnë ndikim përtej asaj që parashihet me ligj. Kjo mundësi ka më shumë gjasa të ndodhë kur edhe organi mbikëqyrës, edhe policia, i raportojnë të njëjtës ministri, gjë që potencialisht krijon rreze që çenojnë nivelin e kërkuar të neutralitetit që duhet të ketë Ministria në një situatë të tillë. Kjo mund të vështirësohet edhe më shumë kur organi mbikëqyrës ka përgjegjësi për hetimin e zyrtarëve të lartë të policisë që kanë gjasa të njihen dhe të kenë takime të rregullta me stafin e ministrisë.

³⁴ Neni 10(1).

³⁵ Neni 9(1).

³⁶ Neni 10(3).

³⁷ https://www.epac-eacn.org/downloads/recommendations/doc_view/2-police-oversight-principles.

Udhëzimi Administrativ 01/2017 për kushtet e punës dhe punësimin e zyrtarëve të IPK-së siguron se pas rekrutimit, stafi kalon nëpër një periudhë 6-mujore trajnimi dhe më pas nëpër një periudhë provuese 6-mujore dhe pas përfundimit me sukses të këtyre dy fazave atyre u jepet kontratë e përhershme. Stafi i lartë ka ngritur çështjen e mungesës së sigurisë së punësimit të përhershëm, pasi zyrtarëve të lartë të inspektoratit u është kërkuar të kalojnë nëpër një proces të vlerësimit të brendshëm katër vjet pasi kanë filluar punën në IPK.

Ekzistojnë një sërë mënyrash për të fuqizuar më tej pavarësinë e IPK. Para së gjithash, duhet të zotohen burimet e nevojshme që IPK të pajiset me burimet e duhura njerëzore dhe financiare. Trajnimi i vazhdueshëm në punë dhe ngritja e kapaciteteve për të rritur kapacitetin operativ dhe efikasitetin e IPK janë mjete thelbësore për fuqizimin e pavarësisë së tij operative. Po ashtu i duhet kushtuar vëmendje e mëtejshme rishikimit të regjimit aktual ligjor për anën operacionale të IPK përmes mekanizmit të vazhdueshëm të Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit të Ligjit. Një nga këto mundësi është ndryshimi i Ligjit për IPK për të siguruar më shumë pavarësi për IPK. Për shembull, autoritetet mund të shqyrtojnë mundësinë e riformulimit të Nenit 6 të Ligjit për Inspektoratin Policor.

Parimet e Mbikëqyrjes së Policisë të Partnerëve Evropianë Kundër Korrupsionit thonë:

“Organi mbikëqyrës i policisë duhet të ketë pavarësinë e duhur për të kryer detyrat e veta. Të paktën nuk duhet të jetë pjesë e degës ekzekutive të qeverisë dhe duhet t’i raportojë direkt Parlamentit”.³⁸

Standardet evropiane nuk kërkojnë që të ndalohet punësimi i punonjësve të policisë në organet mbikëqyrëse të policisë, edhe pse organet mbikëqyrëse në disa vende kanë vënë disa kufizime për punonjësit e policisë të jenë në krye të atij organi. Disa shqetësime të posaçme janë shprehur gjatë misionit lidhur me mundësinë e pavarësisë operacionale që mund të kompromentohet kur stafi i IPK largohet nga IPK dhe fiton pozita në polici. Ky kufizim ka për qëllim shmangien e çfarëdo sugjerimi se një punonjës policie që punon në IPK nuk do t’i hetonte fuqimisht kolegët e vet, sepse kjo do të mund të cënonte marrëdhëniet e ardhshme kur ai ose ajo të kthehet në polici. Kjo është një qasje që është prezantuar në Irlandën e Veriut dhe në Angli e Uells dhe mbështetet përgjegjësisht edhe në vende të tjera.³⁹

5. Konkluzione dhe rekomandime

Si rezultat i misionit vlerësues dhe analizës së dokumentave dhe praktikës së konsulentëve, del se normat ligjore që rregullojnë funksionimin e IPK janë në përputhje me pjesën më të madhe të standardeve evropiane. Në përgjithësi, stafi

³⁸ Shih edhe Doracakun për Vlerësimin e Efektivitetit/Efikasitetit të Organeve Mbikëqyrëse të Policisë. **Partnerët Evropianë Kundër Korrupsionit** është një rrjet i pavarur që ka bërë bashkë më shumë se 60 autoritete anti-korrupsion dhe organe mbikëqyrëse të policisë nga Vendet Anëtare të Këshillit të Evropës.

³⁹ Shih 2.2.7 të parimeve të PEKK.

dhe struktura e IPK janë të duhurat dhe IPK dukshëm ka pavarësi nga vetë policia. Po ashtu IPK ka pavarësi funksionale nga MPB dhe stafi i saj janë të përkushtuar në implementimin e mandatit në mënyrë efikase si dhe në zhvillimin e kapaciteteve të mëtejshme të inspektimit përmes trajnimeve profesionale dhe ndërtimit të kapacitetit. Në nivel kushtetues, mbikëqyrja nga prokuroria e hetimeve penale që ndërmerr IPK është garanci për pavarësinë.

Megjithatë, ka ende hapësirë për përmirësim ashtu si kemi përkshuar më lart dhe kemi përmbledhur më poshtë. Shpresojmë se këto rekomandime do të ndihmojnë në rritjen e mëtejshme të besimit në dhe të autoritetit të IPK dhe si rezultat, të sigurohet efektivitet më i madh në një mjedis shumë sfidues.

Lista e sugjerimeve dhe rekomandimeve specifike:

- IPK duhet të monitorojë shembuj të zyrtarëve të policisë që ngurrojnë të dorëzojnë dosjet tek IPK për rishikim, sidomos kur IPK kërkon dosje të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Nëse paraqitet kjo situatë, IPK duhet të shfrytëzojë procedurat në dispozicion, përfshirë përmes takimeve të rregullta, për të zgjidhur çështjet dhe problemin e komunikimit me zyrtarë të policisë. Nëse kjo nuk e zgjidh çështjen, IPK duhet të shfrytëzojë fuqitë e veta për të sanksionuar zyrtarët hezitues / refuzues.
- IPK duhet të shfrytëzojë procedurat ekzistuese, edhe përmes takimeve të rregullta, për të zgjidhur çështjet e komunikimit dhe problemin e zyrtarëve të policisë që ngurrojnë të dorëzojnë dosjet pranë IPK për t'i shqyrtuar, sidomos kur IPK ka kërkuar dosje të përzgjedhura në mënyrë rastësore. Nëse kjo nuk e zgjidh situatën, IPK duhet të përdorë fuqinë që ka për të sanksionuar zyrtarët që ngurrojnë.
- Duhet të vihen burime në dispozicion për të iniciuar trajnimin e avancuar për stafin e IPK, ndoshta duke përfshirë edhe ekspertë nga vende të tjera dhe vizita studimore tek organe të tjera mbikëqyrëse policore. Ky trajnim i avancuar duhet të dizajnohet specifikisht për punën e IPK.
- IPK duhet të hartojë një listë të ngushtë të nevojave prioritare për trajnim që duhet të planifikohen dhe implementohen gjatë vitit të ardhshëm dhe të kërkojë burime të jashtme për ofrimin e trajnimit që nuk mund të ofrohet nga Akademia. IPK gjithashtu ka nevojë për regjim të qartë trajnimi:
 - Trajnim prezantues për stafin e ri – ky trajnim duhet të mbulojë ligjin dhe sistemin e ankesave, shkathtësitë hetimore në fusha të ndryshme që mbulohen nga IPK dhe që trajtohen më shpesh, teknikat e intervistimit, mbledhjen dhe ruajtjen e provave (përfshirë provat mjeko-ligjore)
 - Trajnim të avancuar për rolet e ndryshme brenda IPK, si dhe trajnim të specializuar për të identifikuar krimet dhe sjelljen e pahijshme kur vetë të dyshuarit janë ekspertë të funksionimit të sistemit të drejtësisë penale

- Trajnime të avancuara për planifikimin e buxhetit, menaxhimin dhe prokurimin vetëm për stafin e specializuar
- Trajnime për zhvillimin e strategjisë së komunikimit dhe marrëdhënieve publike me qëllimin që puna e IPK të bëhet më dukshme dhe të rritet vetëdijësimi i publikut të gjerë për funksionet e IPK
- Edhe pse nuk është përgjegjësi e IPK, konflikti i interesit, që mund të rezultojë kur prokurorët punojnë rregullisht me zyrtarët e policisë dhe që duhet të shmanget duke caktuar prokurorë të posaçëm me të cilët të punojë IPK. Po ashtu duhet të ekzistojnë një sërë rregullash më të qarta që prokurorët të identifikojnë dhe të shmangin konfliktet.
- Vështirësia e komunikimit të çështjeve me prokurorët duhet të zgjidhet, ndoshta përmes një Memorandumi të Mirëkuptimit të hollësishëm ku përcaktohen përgjegjësitë e prokurorëve dhe të IPK.
- Vështirësia për mbajtjen e testeve për integritetin duhet të zgjidhet dhe të kultivohen marrëdhënie më të mira pune me prokurorinë (por duke siguruar se pengesa kundër shtytjes të respektohet).
- Fuqitë e nevojshme mbikëqyrëse, burimet për të krijuar njësinë e mbikëqyrjes që të përdorë mjete teknologjike për të mbledhur prova dhe shkathtësia për të zhvilluar rrjetin e informatorëve duhet të zhvillohet dhe të vihet në dispozicion të IPK sapo IPK të jetë në pozitën që t'i përdorë ato si duhet dhe me kujdes në përputhje me standardet evropiane të paraqitura më lart, me legjislacionin e Kosovës për procedurën penale dhe ligjet e tjera relevante. Nëse nevojitet, duhet të krijohen edhe masa të tjera sigurie për të parandaluar abuzimin potencial.
- Shtabi i IPK gjendet jashtë qytetit dhe në një zonë të izoluar jo të këndshme, gjë që nuk i kontribuon rëndësisë së këtij organi, apo qasjes ose besimit në të, ndaj duhet shqyrtuar mundësia që IPK t'i jepen zyra në qytet në mënyrë që të sigurojë dhe rrijen e vetëdijësimit të vizitorëve dhe atyre që ushtrojnë ankesa. Zhvillimi i zyrave rajonale duhet të vazhdojë. Duhet të fillojë një fushatë vetëdijësimi me fokus tek IPK dhe për këtë të caktohen burimet e duhura. Informatat duhet të shpërndahen sa më shumë në mënyrë që shumica e qytetarëve të kuptojnë të drejtën e tyre për të ushtruar ankesë dhe si punon dhe gjithashtu duhet të synojë ata që kanë më shumë gjasa të kenë ndërveprime të vështira me policinë. Grupe të tilla përfshijnë gratë, njerëz nga minoritetet etnike, të rinjtë, grupet protestuese dhe njerëz të tjerë të cënueshëm dhe informacioni duhet të vihet në dispozicion në vendet që ata kanë më shumë gjasa të vizitojnë, për shembull, vende ku ka mundësi të shkojnë për ndihmë gratë që vuajnë nga dhuna në familje, si stacionet policore, strehimoret e specializuara etj. Duhet të merren masa që materiali të jetë edhe në gjuhë të tjera që nuk janë të shumicës (edhe në uebfaqen e IPK-së).

- Është e qartë se IPK duhet të rekrutojë staf shtesë për t'u marrë me volumin aktual të punës, të krijojë dhe udhëheqë më shumë zyra rajonale në të gjithë Kosovën dhe ka nevojë për ekspertizë shtesë në një sërë sferash si dhe për burime që të paguajë për këto (sidomos për ekspertë mjeko-ligjorë).
- Duhet marrë në konsideratë mundësia për të siguruar stafin e lartë se punësimi i tyre do të jetë i sigurtë edhe pas katër vjetësh nëse ata performojnë mirë dhe vlerësimi katër-vjeçar do të mbështetet në kritere objektive dhe transparente.
- IPK ka nevojë për një dhomë të sigurtë për provat gjatë hetimeve dhe para se e gjithë dosja të transferohet tek prokuroria për shqyrtim.
- Një numër i konsiderueshëm i rekomandimeve të lartpërmendura do të kërkojë rritje të konsiderueshme të buxhetit të IPK-së. Ne rekomandojmë që buxheti të rritet shpejt me mbështetje nga Ministri i Punëve të Brendshme.
- Investimi në burimet njerëzore dhe financiare, trajnimi i duhur dhe veprimet e tjera të ndërlidhura duhet të konsiderohen si prioritet në mënyrë që të rrisin edhe më tej pavarësinë funksionale dhe operacionale të IPK. Po ashtu, duhen marrë në konsideratë edhe rishikime të mëtejshme legislative, edhe përmes procesit të vazhdueshëm të Rishikimit Funksional të Sektorit të Sundimit Ligjit (duke përfshirë, për shembull, largimin e dispozitës që thotë se IPK është institucion ekzekutiv i MPB).

Shtojca 1: Biografi të përmbledhura të konsulentëve ndërkombëtarë

George Tugushi është jurist për të drejtat e njeriut me përvojë praktike dhe teorike në fushën e të drejtave të njeriut me fokus të posaçëm tek parandalimi dhe monitorimi i torturës.

Ai ka diplomuar si jurist nga Universiteti Shtetëror i Tbilisit, Fakulteti i së Drejtës dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare në vitin 1999. Në vitin 2001 ai diplomoi nga Instituti Gjeorgjiano-Amerikan in Administratës Publike (GIPA) me titullin MA në Adminisratë Publike. Në vitin 2004 diplomoi nga Universiteti Lund, Instituti Raoul Wallenberg për të drejtat e Njeriut dhe të Drejtën Humanitare me titullin LL.M. në të Drejtën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Që nga janari 2012 ai ndjek studimet e doktoraturës pranë Fakultetit Juridik të Universitetit Shtetëror të Tbilisit.

George Tugushi po kryen mandatin e tretë me radhë si anëtar i zgjedhur i Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT) nga Gjeorgjia, ku për së pari herë u zgjodh në mars të vitit 2005. Aktualisht është kryesues i Grupit Punues për Jurisprudencën të KPT-së. George Tugushi është edhe ish-pjesëtar i Komitetit të OKB-së kundër Torturës (UNCAT), Zëvendëskryesues dhe raportues për masat ndëshkimore për këtë komitet. Ai ka shërbyer edhe si Avokati i Popullit për të Drejtat e Njeriut në Gjeorgji gjatë viteve 2009-2012 dhe ka qenë Kryesues i Mekanizmit Parandalues Kombëtar të krijuar në kuadër të OPCAT. Ai është edhe anëtar i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Jotolerancës (ECRI). Ai ka shërbyer edhe si ekspert për Këshillin e Evropës, Bashkimin Evropian dhe OKB-në në një sërë rastesh ku ka qenë i angazhuar me misione individuale lidhur me krijimin e MVP në Evropën Lindore, analizimin e legjislacionit që ka të bëjë me Institucionet Vendore për të Drejtat e Njeriut dhe MVP dhe ka mbajtur trajnime për anëtarë të MVP dhe Institucioneve të Avokatit të Popullit në pjesë të ndryshme të botës, përfshirë Evropën dhe Azinë. Përvoja e tij e punës përfshin edhe pozita në OSBE, UNDP dhe projekte të ndryshme të BE-së të implementuara nga kompania austriake “Human Dynamics”. Z. Tugushi ligjeron të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut pranë Institutit Gjeorgjian për Çështje Publike që nga viti 2005.

John Wadham: Kryetar i Mekanizmit Parandalues Vendor në MB

Më herët: Drejtor Ekzekutiv, INTERIGHTS (Qendra Ndërkombëtare për Mbrojtjen Ligjore të të Drejtave të Njeriut); Këshilltar i Përgjithshëm, Komisioni për Barazi dhe të Drejta të Njeriut; Zëvendëskryesues, Komisioni i Pavarur për Ankesa ndaj Policisë dhe Drejtor në Liberty.

Anëtar i Komitetit për të Drejta të Njeriut të Shoqërisë Ligjore; Këshilltar i Lartë për Hulumtime i Angazhuar, Kings College në Londër; ligjërues i angazhuar, Bristol University; ligjërues i angazhuar, University of Auckland dhe ligjërues nderi University of Leicester. Autor i Udhërrëfyesit Blackstone për Ligjin për të Drejtat e Njeriut, Udhërrëfyesit Blackstone për FOIA dhe Udhërrëfyesit Blackstone për Ligjin për Barazi.

Projektet më të reja si ekspert/konsulent: **Projekti për Implementimin e të Drejtave të Njeriut, University of Bristol:** intervenimet dhe amicus në rastet pranë Gjykatës Afrikane dhe Komisionit për të Drejtat Njerëzore dhe të Popujve **Sekretariati i Komonuelthit:** (1) Vlerësimi i Komisionit Kombëtar për të Drejtat e Njeriut në Ishujt Sejshell dhe (2) Sundimi i ligjit, anëtar i panelit të ekspertëve **Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara:** (1) Këshillim dhe trajnim *Këshilli për Barazi i Moldavisë* parimet e mosdiskriminimit dhe shkruarja e vendimeve; (2) Raport nga hulumtimi për vendime mbi diskriminimin nga gjykatat dhe Këshilli për Barazi i Moldavisë; (3) Raport nga hulumtimi për strukturat rajonale: *Avokati i Popullit, Ukrainë*; (4) *Qeveria e Gjeorgjisë* për Konventën mbi të Drejtat e Njerëzve me Aftësi të Kufizuar (koordinim, pikat kontaktuese dhe ngritja e kapaciteteve). **Projekte të Këshillit të Evropës:** **Shqipëri:** *Efektiviteti i sistemit shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe antidiskriminimit*; **Armeni:** (1) *Diskriminimi dhe ndalimi i torturës*; (2) *Ndalimi i torturës dhe paraburgimi arbitrar – trajnim i gjyqtarëve*; (3) *Lufta kundër Keqtrajtimit dhe Mosndëshkimit*; (4) *Vlerësimi i respektimit të KEDNJ-së në draftin e Kodit Penal*; **Azerbajxhan:** (1) *Liria dhe paraburgimi arbitrar*; (2) *Zhvillimi i Kurrikulumit të KEDNJ-së për trajnimin e gjyqtarëve pranë Akademisë së Drejtësisë*; **Gjeorgji:** (1) *Dhuna gjinore dhe diskriminimi*, dhe (2) *Amicus Curiae dhe avokati publik*; (3) *trajnim i gjyqtarëve për krimin e urrejtjes pranë Akademisë së Drejtësisë*; **Platforma HELP** (1) *Hetimi paragjyqësor*; (2) *Neni 5, arresti dhe mbajtja në paraburgim*; **Kazakistan:** *ekspert për Mekanizmat Parandalues Vendorë*; **“Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë”:** (2) *vlerësimi ligjor i Ligjit për Policinë dhe Protestat*; (2) *program trajnimi për zyrtarë të policisë që të shmangin keqtrajtimin*; (3) *program trajnimi për Ministrinë e Punëve të Brendshme: hetimi i sjelljes së pahijshme nga zyrtarët e policisë*; **Moldavi:** (1) *Gjykata Kushtetuese e Moldavisë: Mbrojtja e të dhënave personale*; (2) *Krimi i urrejtjes, diskriminimi dhe liria e shprehjes*; (3) *Sçështje gjyqësore strategjike për të drejtat e njeriut*; **Mali i Zi:** *Mbrojtja e të drejtave të njeriut të personave në paraburgim dhe të dënuar për të shmangur keqtrajtimin nga zyrtarët e policisë*; **Rumani:** *Përgatitja e materialeve për trajnim dhe udhëheqja e trajnimit të zyrtarëve të policisë që janë përgjegjës për paraburgimin në Rumani për çështje të keqtrajtimit përgjatë pesë seinareve dy-ditore* **Serbi:** (1) *Vlerësimi i sistemit të ankesave ndaj policisë*; (2) *Vlerësimi i sistemit të pavarur mbikëqyrës të ankesave ndaj policisë*; **Orientimi seksual dhe identiteti gjinor:** panel me ekspertë; **Turqi:** *Liria e shprehjes dhe informatat personale, trajnimi i gjyqtarëve*; **Ukrainë:** (1) *Hetime policore efektive*; (2) *Opinion i Këshillit të Evropës për Byronë Speciale të Hetimeve*; (3) *Trajnim, Neni 6 i KEDNJ-së, e drejta për gjykim të drejtë gjatë procedurës penale*; (4) *Zbatimi i gjykimeve nga GJEDNJ, vlerësimi i procedurave të brendshme qeveritare*.

SHTOJCA II:

Komentet e përfituesit mbi Raportin e Vlerësimit të Inspektoratit Policor të Kosovës

Lidhur me rekomandimin e parë që ka të bëjë me komunikimin me Policinë e Kosovës dhe problemet që janë paraqitur sa i përket qasjes në disa dokumenta të ndjeshëm, ashtu si u përmend gjatë takimit, mund të jenë disa raste të veçanta dhe që janë sqaruar me kohë dhe IPK nuk ka patur ndonjë problem me pranimin e çfarëdo dokumenti nga Policia e Kosovës për qëllime të hetimit apo inspektimit.

Lidhur me rekomandimin që ka të bëjë me komunikimin me prokurorët dhe konfliktin potencial të interesit me ta, IPK në përgjithësi ka bashkëpunim të mirë me të gjitha prokuroritë dhe të gjitha këto prokurori kanë një prokuror të caktuar që është përgjegjës për konsultime fillestare për të gjitha rastet e trajtuara nga IPK. Caktimi i rasteve dhe i kompetencave për prokurorët bëhet në përputhje me rregullat e Prokurorisë dhe është jashtë fushëveprimit të IPK të përcaktojë se cilët prokurorë duhet të merren me rastet që IPK paraqet në prokurori. Ne pajtohemi me vlerësimin se caktimi i prokurorëve që do të merreshin ekskluzivisht me rastet e paraqitura nga IPK do ta bënte më efikas procesin e trajtimit të rasteve kundër policisë.

Sa i përket rekomandimit që ka të bëjë me statusin e zyrtarëve të IPK, duke iu referuar Udhëzimit Administrativ 01/2017 për kushtet e punës dhe punësimin e zyrtarëve të IPK, zyrtarët operativë IPK, pas rekrutimit, kalojnë nëpër një periudhë trajnimi 6-mujor dhe pas përfundimit me sukses të trajnimit, ata kalojnë nëpër një periudhë provuese 6-mujore. Pas përfundimit me sukses të të dyja këtyre fazave, ata nënshkruajnë kontratën e përhershme. Prandaj, konkluzioni se stafi i IPK ka status të përkohshëm nuk është i vërtetë. Mandati katër-vjeçar është i zbatueshëm vetëm për pozitën e menaxhmentit të lartë dhe çdo katër vjet ata i nënshtrohen procesit të rekrutimit të brendshëm, ashtu si përcaktohet me procedurat e Udhëzimit Administrativ.

Duke iu referuar rekomandimit nr. 12, deklarata se rritja e buxhetit duhet të bëhet me “mbështetje publike eksplicite nga Ministri i MPB-së”, Ministri vazhdimisht mbështet rritjen e buxhetit të IPK, si publikisht, ashtu edhe gjatë diskutimeve të brendshme me qeverinë dhe Ministrinë e Financave. Në mënyrë më specifike, gjatë diskutimeve të fundit për IPK, Ministri ka kërkuar mbështetjen dhe përfshirjen nga Kuvendi, të Komisionit për Çështje të Brendshme dhe palë të tjera relevante që të ndihmojnë me zgjidhjen e problemeve të kohëve të fundit në IPK, si dhe me përmirësimin e funksionimit dhe llogaridhënies së IPK.

Lidhur me rekomandimin për “rishikime të mëtejshme legislative ... (përfshirë, për shembull, largimin e dispojitës që thotë se IPK është institucion ekzekutiv i MPB-së” raporti nuk paraqet analizë apo argumente të mjaftueshme që do të mbështesnin rekomandimin për largimin e IPK si institucion ekzekutiv brenda MBP-së. Për më tepër, nuk ka ndonjë analizë krahasuese për të mirat e vendosjes së agjencisë nën mbikëqyrjen e Kuvendit në Kosovë. Gjithashtu, sa i përket deklaratës brenda të njëjtit rekomandim për “fuqizimin e pavarësisë buxhetore të IPK duke e larguar nga buxheti i MPB-së”, raporti nuk paraqet asnjë dëshmi se ka ndonjë problem me sistemin aktual. IPK ka të njëjtën pavarësi buxhetore si Policia e Kosovës dhe deri më sot nuk ka shqetësime nga PIK apo PK sa i përket menaxhimit dhe pavarësisë së buxhetit. Ndaj, ne rekomandojmë largimin e këtyre dy rekomandimeve.